



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 21.1.1- 2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, Qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Kryeministrit në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Emine Fazliu, e mbështetur nga, Riza Spanca (Udhëheqës Ekipi), Mazlumsha Sejfadini, Erëmira Bytyqi-Pllana (anëtar ekipi).

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	11
4 Qeverisja.....	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	29
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	32

## Përmbledhje e përgjithshme


### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falenderojmë, Kryeministrin dhe stafin e tij përfshirë agjencitë për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Në kuadër të këtij auditimi janë përfshirë edhe agjencitë vartëse si: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (AShAK) dhe Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj).

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë e reflekton qasjen e paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të Auditimit, e datës 7 nëntor 2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


#### ***Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes***

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

*Theksim i çështjes* - Dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për subvencione nuk mbështeten me dëshmi të mjaftueshme për të siguruar përdorimin e tyre për qëllime të caktuara.

**(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)**

**Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:**



**Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2014**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do të adresojnë rekomandimet tona.

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti, mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF-ve, merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve, përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

#### **Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes**

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

*Theksim i çështjes* - Dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për subvencione nuk mbështeten me dëshmi të mjaftueshme për të siguruar përdorimin e tyre për qëllime të caktuara.

**(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)**



## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memorandumin e Planifikimit të Auditimit të datës 07.11.2014, është identifikuar një rrezik në lidhje me procedurën e dhënies dhe arsyetimin e subvencioneve. Edhe përkundër dhënies së këshilles sonë në memon e ndërmjetme të auditimit, menaxhmenti i ZKM-së nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim deri në kohën e përfundimit të fazës finale të auditimit.

### Rreziku i identifikuar

**Çështja 1-Prioritet i lartë - Mungonin dëshmi rreth arsyetimit të shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve**

### Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti, për të siguruar se mjetet e dhëna për subvencione dhe transfere janë dhënë në pajtim me fushëveprimtarinë e ZKM-së si dhe për mënyrën e raportimit të tyre. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, kemi këshilluar menaxhmentin që të sigurojë dëshmi adekuate, për të mbështetur shpenzimet e ndodhura. Ky rrezik ishte materializuar, pasi që në këtë kategori niveli i kontrollit të brendshëm nuk ishte në nivelin e duhur. Në shtatë subvencione të dhëna me vendimin e Kryeministrit në vlerë 67,800€, përfituesit nuk kishin ofruar raporte përshkruese mbi arsyeshmërin e shpenzimit, fatura si dhe dëshmi tjera përcjellëse.

**Rekomandimi 1** ZKA duhet të shtojë masat e kontrollit të brendshëm për të siguruar se përfituesit e subvencioneve sjellin dëshmi të kompletuara rreth shpenzimit të tyre, në mënyrë që mjetet e dhëna janë shfrytëzuar për qëllimet e caktuara të vendimit të dhënë.

## 2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

### Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për PVF-të e Organizatave Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat që PVF, të janë nënshkruar nga ZKA dhe nga ZKF dhe janë dorëzuar në MF;
- Kërkesat e rregullores 01/2013 - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Në kontekst të PVF-ve, çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 19.12.2014, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Në draft Pasqyrat Financiare ishin të nevojshme disa korrigjime. Ne kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për të përmirësuar shpalosjet përshkruese dhe për të siguruar plotësinë e tyre. Pas sugjerimeve tona, draft- PVF-të janë korrigjuar duke i evituar gabimet e identifikuar.

Marrë parasysh këto korrigjime të kryera - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft- PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ZKM kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet operative;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit në kohë; dhe
- Raportin mbi kontrollet e brendshme, përfshirë raportin e vetë-vlerësimit.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto. Të gjitha raportet janë dorëzuar në MF dhe institucionet e tjera gjegjëse brenda afateve kohore.

### Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Që nga pranimi i raportit tonë të auditimit për vitin 2013, menaxhmenti i ZKM-së nuk kishte ndërmarrë veprime të mjaftueshme për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Menaxhmenti duhet të jetë më proaktiv për të siguruar evitimin e mangësive të identifikuara, përfshirë edhe rekomandimet e dhëna para vitit 2013, e që edhe më tutje qëndrojnë të pa adresuara.

#### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të ZKM-së, ka rezultuar me 19 rekomandime. ZKM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet, megjithatë niveli i implementimit të tyre mbetet i ulët.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, dy rekomandime janë adresuar plotësisht, shtatë pjesërisht, ndërsa 10 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

#### Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- |                      |   |
|----------------------|---|
| <b>E gjetura</b>     | Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar dhe si pasojë mangësi të njëjta ishin prezente edhe në 2014.  |
| <b>Rreziku</b>       | Mos implementimi i rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, ndikon në ekzekutimin e dobët të buxhetit si dhe në mos efikasitet të vazhdueshëm operativ në disa fusha.  |
| <b>Rekomandimi 2</b> | ZKA në bashkëpunim me Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive, duhet të sigurojë që plani i veprimit është rishikuar dhe se përcakton qartazi veprimet praktike dhe afatet kohore për adresimin e rekomandimeve, duke përfshirë stafin përgjegjës të identifikuar dhe me fokus fillestar në fushat me mangësi të theksuara. |

## 4 Qeverisja

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe rezultateve nga këto veprime. Ne konsiderojmë se në përgjithësi, kontrollet e nivelit të ulët dhe të nivelit të mesëm pjesërisht janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë relativisht efektive.

Kontrollet mbi të hyrat pjesërisht ishin efektive, ndërsa kontrollet rreth kategorive të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që ZKM të ketë vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të buxhetit. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: realizimi i buxhetit, menaxhimi i pasurisë, menaxhimi i shpenzimeve nga mallrat dhe shërbimet si dhe mbyllja e avanceve.

## 4.1 Qeverisja e mirë

### Përshkrim

ZKM është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet financiare dhe menaxheriale të agjencive të saj vartëse<sup>1</sup>. Ato kanë strukturën e vet organizative dhe prodhojnë pasqyrat financiare individuale të cilat më pas konsolidohen në pasqyrat financiare të ZKM-së.

---

### Çështja 3 – Linjat e papërshtatshme të llogaridhënies – Prioriteti i lartë

**E gjetura** Raportimi i brendshëm dhe linjat e llogaridhënies ndërmjet ZKM-së dhe agjencive ekzekutive vazhdojnë të jenë një sfidë e veçantë. Procesi i konsolidimit të PVF-ve dhe raportimeve tjera nuk ishte efektiv për shkak të linjave të papërshtatshme të llogaridhënies. Kryeshefat Ekzekutiv të agjencive raportojnë tek Zëvendës Kryeministrat përkatës, derisa Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për pasqyrat e konsoliduara financiare. Për qëllime të konsolidimit të pasqyrave financiare, agjencitë dërgojnë raporte financiare mirëpo ato shpesh janë të një cilësie të pamjaftueshme.

Po ashtu komunikimi dhe raportimi brenda ZKM-së, përfshirë edhe agjencitë, nuk ishte ende në nivelin e duhur. Përgjatë vitit, menaxherët e departamenteve kishin dorëzuar rregullisht raporte javore tek Sekretari i Përgjithshëm. Mirëpo informatat e prezantuara në këto raporte ishin të mangëta, nuk përmbanin ndonjë analizë të detajuar rreth planifikimit dhe ekzekutimit buxhetor.

**Rreziku** Sistemi ekzistues i llogaridhënies dhe raportimit të brendshëm, nuk i siguron menaxhmentit informata të përshtatshme dhe të mjaftueshme për qëllime të llogaridhënies, mbikëqyrjes dhe vendimarrjes efektive.

**Rekomandimi 3** ZKA duhet të bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave të raportimit të vendosura mbi agjencitë dhe departamentet, në mënyrë që të sigurohen mekanizma efikase të raportimit për të mbështetur menaxhimin financiar dhe kualitativ në kohë.

---

<sup>1</sup> Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (AShAK), Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) dhe Këshilli I Sigurisë I Kosovës (KSK), Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRSB).

---

## 4.2 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ZKM, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>12,401,511</b>	<b>12,045,484</b>	<b>10,090,142</b>	<b>9,275,391</b>	<b>9,123,576</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	12,019,338	10,917,629	9,418,659	8,785,284	8,603,436
Të hyrat e bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -		195,008	190,652	100,129	0
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	382,173	311,915	140,831	166,087	261,888
Donacionet e brendshme	0	19,547	0	0	218,695
Donacionet e jashtme	0	601,385	340,000	223,891	39,557

Buxheti fillestar ishte përshtatur në disa raste gjatë vitit. Në një të anë, fondet e parashikuara nga granti Qeveritar dhe nga të hyrat vetanake ishin zvogëluar. Në anën tjetër ishin shtuar fonde të reja, fillimisht të pabuxhetuara, nga të hyrat e bartura, donacione të brendshme dhe donacione të jashtme. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, buxheti final ishte më i ulët nga buxheti fillestar për 356,027€.

Pas përshtatjeve buxhetore të përshkruara më lartë, realizimi i përgjithshëm i buxhetit ishte rreth 84% nga buxheti final, përderisa në vitin 2013 ishte 78%. Ndryshimet buxhetore si dhe arsytet për ndryshime janë si në vijim:

- Vendimi i Qeverisë nr. 07/172 për kursimin e 15% të shpenzimeve të OB-ve dhe vendimi i ZKM-së që një pjesë të buxhetit të pashpenzuar për projekte kapitale ta deklarojë si kursime ka ndikuar në shkurtimin e buxhetit; si dhe
- Në anën tjetër vendimi i Qeverisë nr. 07/03 për rritje të pagave për 25%, donacionet e brendshme në vlerë prej 19,547€, donacionet e jashtme prej 601,385€, rritja e hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar për 195,008€, vendimet e Qeverisë për aktivitetet kanë ndikuar në rritjen e buxhetit të ZKM-së.

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të ZKM-së të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>12,401,511</b>	<b>12,045,487</b>	<b>10,090,144</b>	<b>9,275,388</b>	<b>9,125,222</b>
Pagat dhe Mëditjet	3,600,743	3,994,021	3,885,134	3,192,556	3,006,973
Mallrat dhe Shërbimet	3,428,970	3,421,121	2,836,490	3,360,023	2,955,591
Shërbimet komunale	239,798	207,428	134,430	119,895	135,001
Subvencionet dhe Transferet	1,480,000	1,986,084	1,512,375	1,173,989	1,211,450
Investimet Kapitale	3,652,000	2,436,833	1,721,715	1,428,925	1,816,207

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për Paga dhe Mëditje është rritur për 393,277€. Kjo rritje ka rezultuar sipas vendimit të Qeverisë për rritje të pagave prej 25 % apo në vlerë prej 294,053€. Pjesa tjetër ishte për stafin e përfshirë në “Fondin për Kuadro” në vlerë 70,904€, si dhe donacionet e pranuar për kategorinë e pagave 28,321€. Në fund të vitit mbi 100,000€ kanë mbetur të pashpenzuara për shkak të numrit më të vogël të punëtorëve aktual se atyre të buxhetuar.
- Fillimisht buxheti për mallra dhe shërbime është zbritur në bazë të vendimit të Qeverisë për kursime prej 15% apo në shumën prej 443,652€. Pastaj i njëjti buxhet është rritur për 435,802€, prej tyre 144,280€<sup>5</sup> nga granti qeveritar, 115,801€ nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar si dhe 175,721€ nga donacionet e jashtme. Përkundër ndryshimeve të bëra, buxheti final ishte përafërisht i njëjtë me buxhetin fillestar. Ndërsa realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte në nivel prej 83% nga buxheti final. Po ashtu, buxheti për shërbimet komunale ishte zvogëluar në bazë të vendimit të qeverisë për kursim në vlerë 35,370€.
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 506,084€. Prej tyre 100,000€ ishin ndarë nga Qeveria për financimin e aktivitetit “Shënimi i gjashtë vjetorit të pavarësisë”, 396,902€ ishin donacione të jashtme për Zyrën për Komunitete dhe 9,182€ nga donacionet e brendshme. Buxheti në këtë kategori ishte shpenzuar në masën 76%, ku pjesa më e madhe ishte shpenzuar për integrimin e komuniteteve pakicë. Shuma prej 215,000€ nga donacionet, ishte bartur për t’u shpenzuar në vitin 2015, pasi që projekti ishte ende në proces të implementimit.

<sup>5</sup> Vendimi për mbulimin e shpenzimeve të punës së Sekretarisë së Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorëve dhe veteranëve të UCK-së (50,000€), për ceremoninë e rivarrimit të eshtrave të Isa Boletinit (50,000€), për Komisionin Qeveritar për Kufijtë e RKS (44,280€).

- Buxheti fillestar për investime kapitale ishte reduktuar për 1,215,167€. Prej tyre 1,000,000€ ishin ndarë për një projekt të bashkëfinancuar me zyrën e BE-së<sup>6</sup>. Realizimi i projektit ishte vonuar për shkak të vonesave në përcaktimin e lokacionit për ndërtimin e fabrikës, ndërsa mjetet ishin bartur për vitin 2015. Shuma prej 215,167€ ka të bëjë me projektet tjera të AUV-it<sup>7</sup>, të cilat nuk ishin realizuar, kurse mjetet ishin deklaruar si kursime. Në anën tjetër ZKM kishte marrë donacione për investime kapitale në vlerë prej 10,365€. Përkundër kursimeve të deklaruara, vetëm 70% e buxhetit final ishte realizuar.

**Tabela 3. Të Hyrat e inkasuara për Buxhetin e Kosovës (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Të hyrat vetanake	382,173	506,923	5,287,972	4,826,775	4,258,169
Donacionet e jashtme			107,500	664,894	87,953
<b>Totali</b>	<b>382,173</b>	<b>506,923</b>	<b>5,395,472</b>	<b>5,491,669</b>	<b>4,346,122</b>

Nga totali i të hyrave vetanake, 506,923€ ishin lejuar të shpenzohen për nevojat e AUV-it dhe ASHAK-ut. Të hyrat e vitit 2014 krahasuar me vitin paraprak ishin rritur për 461,197€. Rritja ishte rezultat i shtimit të aktiviteteve nga AUV për mbledhjen e tyre. Përderisa donacionet, kishin rënie prej 557,394€, pasi që shumën e pranuar në vitin 2013 ende shfrytëzohej për implementim të projekteve në vazhdimësi.

<sup>6</sup> Bashkëfinancimi i projektit “Ndërtimi i fabrikës së riciklimit të mbeturinave shtazore” në vlerë 7,700,000€ në mes të Qeverisë dhe zyrës së BE-së (5.7 mil. Financuar nga BE-ja si dhe 2 mil€ nga Qeveria e Kosovës).

<sup>7</sup> Projekti “Ndërtimi i fabrikës së riciklimit të mbeturinave shtazore” në vlerë prej 118,999€, projekti “Furnizime me TI” në vlerë prej 100,000€ si dhe 6,532€ nga projekte tjera.



#### Çështja 4 - Realizimi jo i mirë i buxhetit - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit të investimeve kapitale ishte 70% e buxhetit final. Kjo ishte rrjedhojë e planifikimit jo të mirë për këtë kategori, vonesave në procedurat e prokurimit si dhe ankesave të Operatorëve Ekonomik (OE) në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Ekzekutimi i njëjtë i buxhetit ishte edhe në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve si dhe në shërbimet komunale. Ndërsa obligimet e paguara në PVF ishin në vlerë 192,791€.
- Rreziku** Planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe realizimi i ulët i buxhetit sidomos të investimeve kapitale, pasqyron një mospërputhje në mes planit dhe shpenzimeve. Mos fillimi i procedurave të prokurimit me kohë, vonesat në realizimin e investimeve kapitale për një numër të projekteve, si dhe rritja e obligimeve, rrezikon realizimin e tyre sipas afatit të paraparë si dhe arritjen e objektivave të ZKM-së.
- Rekomandimi 4** ZKA së bashku me Kryeshefat ekzekutiv, duhet të sigurojnë që planifikimit buxhetor ti paraprijë një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron plotësisht të gjithë informacionin e duhur, përfshirë rezultatet e vitit paraprak. Nëse vlerësimet buxhetore nuk janë të sakta, të përcaktohen opsione praktike për përmirësim, dhe kjo të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit të vitit vijues.

#### Çështja 5 - Pagesa e furnizimeve me mallra dhe shërbime nga investimet kapitale - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Në AUV furnizimet<sup>8</sup> e ndryshme ishin buxhetuar si investime kapitale si dhe janë paguar nga ky buxhet derisa rregullat e thesarit i kategorizojnë si mallra dhe shërbime. Vlera e këtyre furnizimeve ishte 1,548,272€. ZKM ishte përpjekur edhe këtë vit që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF) të korrigjojë kategorinë buxhetore, por nuk ishte arritur të adresohet nga MF. Kjo çështje ishte paraqitur dhe shpalosur detajisht në PVF.
- Rreziku** Buxheti për projektet e cekura më lartë ishte klasifikuar gabimisht, si rezultat shpenzimi i tyre ndikon në paraqitjen jo të drejtë dhe në besueshmërinë e pasqyrave financiare. Kjo kishte ndikuar që të mbivlerësohen dukshëm investimet kapitale dhe të nënvlerësohen mallrat dhe shërbimet.
- Rekomandimi 5** ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it, në bashkëpunim me MF-in duhet të sigurojnë se buxhetimi/shpenzimi i parasë realizohet vetëm nga kategoria adekuate dhe në këtë mënyrë të kemi një paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare.

---

<sup>8</sup> Projektet për "Mbrojtja e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve", "Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve", "Monitorimi i mbetjeve të medikamenteve veterinarë" si dhe disa projekte të tjera të natyrës së njëjtë.

---

## 4.3 Të hyrat

### Përshkrimi

Gjatë vitit 2014, ZKM së bashku me agjencitë vartëse kishte realizuar të hyra në vlerë 5,395,472€. Prej tyre 5,160,943€ (apo 95.6%) ishin realizuar nga AUV.

ZKM kishte vendosur një sistem të mirëfilltë për mbledhjen, evidentimin dhe raportimin e të hyrave. Edhe përkundër konstatimit se të hyrat e ZKM dhe agjencive vartëse janë regjistruar dhe barazuar me thesarin, për të mbështetur saktësinë dhe plotësinë nevojitet sistemi për menaxhimin e të hyrave.

---

### Çështja 6 – Mungesa e softuerit për regjistrimin e të hyrave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Menaxhimi i të hyrave në AUV duke filluar nga aplikacioni, faturimi, regjistrimi bëhej në mënyrë manuale në mungesë të softuerit. Më tutje, të hyrat nga pesë lloje të certifikatave regjistroheshin në të njëjtin kod ekonomik. Sidoqoftë, ZKM ishte në proces për t'u pajisur me një softuer, por lënda ishte në OSHP për shkak të ankesës nga një ofertues.
- Rreziku** Përpunimi i të hyrave në mënyrë manuale, rritë rrezikun e gabimeve gjatë regjistrimit të tyre. Po ashtu, regjistrimi i disa të hyrave me të njëjtin kod ekonomik vështirëson analizimin dhe shqyrtimin e tyre.
- Rekomandimi 6** ZKA së bashku me Kryeshëfin ekzekutiv të AUV-it, duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për tu pajisur me një softuer adekuat për menaxhimin e të hyrave. Po ashtu, në bashkëpunim me thesarin të shqyrtohet mundësia për krijimin e kodeve ekonomike për secilin lloj të të hyrave.

## **Çështja 7 – Mangësitë e shitjes përmes ankandit publik – Prioritet i mesëm**

- E gjetura** AUV mbledh të hyra edhe nga shitja e mishit nga kafshët e konfiskuara, ku shitja bëhet përmes ankandit. Gjatë vitit 2014, ishin realizuar 32 ankande në periudha të ndryshme dhe ishin mbledhur 76,472€. Në të gjitha ankandet e realizuara, kishte vetëm nga një ofertues edhe pse çmimet fillestare ishin nën vlerën e tregut. Në fillim procesi i shitjes nuk ishte i rregulluar, derisa vonesat në shitje të shkaktuara nga rishpallja e ankandeve kishin rezultuar me prishjen e mishit me vlerë të përafërt me 5,772€. Në fund të muajit tetor, AUV kishte aprovuar rregulloren 04/2014<sup>9</sup> për trajtimin e këtij procesi, megjithatë edhe përkundër rekomandimit të dhënë nga viti paraprak kishte vazhduar zhvillimi i ankandeve me vetëm nga një ofertues.
- Rreziku** Zhvillimi i ankandit me nga vetëm një ofertues rritë rrezikun e shitjes së mishit me çmime të ulëta, si dhe vonesat gjatë shitjes rrezikojnë humbjen e arkëtimeve nga prishja e mallit.
- Rekomandimi 7** Kryeshefi Ekzekutiv i AUV, duhet të shqyrtojë arsyet e interesimit të ulët për blerjen e mishit, të analizojë tregun bazuar në informatat e përfituara për rritjen e numrit të ofertuesve në ankande. Në të kundërtën, të shqyrtojë mundësi tjera më të favorshme për trajtimin e mishit nga kafshët e konfiskuara.

## **4.4 Shpenzimet**

ZKM ka të vendosur një sistem të kontrolleve të brendshme që përcjellin procesin e pagesës dhe menaxhimit të shpenzimeve. Megjithatë, ekzistojnë disa mangësi të cilat duhet të adresohen nga zyrtarët përgjegjës për të siguruar efektivitet maksimal në fushën e kontrolleve.

### **4.4.1 Prokurimi**

#### **Përshkrimi**

Qëllimi i rregullave të prokurimit është të siguroarit se mjetet publike janë përdorur në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore definon qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshin kërkesën për zvogëlimin e rrezikut nga vonesat në zotimin e mjeteve, urdhërblerjeve, pranimit të mallit pa komision si dhe pagesat nga mallra dhe shërbime për investime kapitale. Ne kemi testuar 20 (njëzet) procedura të prokurimit si dhe 56 mostra të pagesave në vlerë 866,132€.

---

<sup>9</sup> Rreg. 04/2014 “Procedurat për asgjësimin e kafshëve të gjalla për shkak të sëmundjeve infektive, lartësisë së çmimit për kompensimin e dëmit pronarëve të kafshëve dhe shitjes së produkteve me origjinë shtazore dhe bimore”.

---

## Çështja 8 – Dobësi sistematike në procesimin e pagesave – Prioritet i lartë

**E gjetura** Ne identifikua disa mangësi, ku kontrollet nuk ishin zbatuar në nivel të duhur:

- Në një numër të rasteve<sup>10</sup>, fondet ishin zotuar/urdhërblert ishin lëshuar pas pranimi të faturave respektivisht pas pranimi të furnizimeve. Në tetë furnizime të ndryshme me vlerë të përbashkët prej 39,202€, malli ishte pranuar nga zyrtari pranues, në mungesë të komisionit për pranimin e mallit. Kjo situatë ishte rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të brendshme; dhe
- ZKM kishte blerë pesë lloptop dhe një skaner në vlerë 11,522€. Edhe pse këto pajisje i takojnë kategorisë së investimeve kapitale, për shkak të kategorizimit të gabuar gjatë planifikimit, blerjet ishin realizuar nga buxheti për mallra dhe shërbime. Derisa në një rast tjetër, ishte bërë furnizimi me mobilje në vlerë 7,640€, në bazë të kontratës kornizë, afati i së cilës kishte skaduar një muaj më parë. Kjo kishte ndodhur për shkak të vonesave në incimin e procedurave të prokurimit për këtë lloj të furnizimeve.

**Rreziku** Dobësitë gjatë procesimit të pagesave, pranimi të mallit pa komision si dhe pagesat e investimeve kapitale nga mallrat dhe shërbimet, ndikojnë në rritjen e obligimeve, cilësi të dobët të blerjeve dhe mbivlerësim të kategorisë.

**Rekomandimi 8** ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të analizojnë arsyet e lëshimeve procedurale të lartpërmendura dhe të shtojnë kontrollet për të evituar përsëritjen e tyre në të ardhmen. Të përgatitet një planifikim adekuat i cili siguron se kërkesat në kategoritë buxhetore janë në përputhje me kërkesat për blerje.

---

<sup>10</sup> Në 24 raste zotimi i mjeteve në vlerë totale 419,441€ është bërë pas pranimi të mallrave dhe faturës. Ndërsa në 20 raste në vlerë totale 269,829€ urdhërblert ishin përgatitur dhe nënshkruar pas pranimi të faturës apo pranimi të mallrave/shërbimeve.

---

### Çështja 9 - Mungesa e planeve të menaxhimit të kontratave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas udhëzuesit operativ për prokurim publik, pas pranimit të kontratës, menaxheri i projektit do të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratës. Në shtatë kontrata në AUV, menaxherët e përcaktuar nuk kishin përgatitur planin për menaxhimin e tyre, kjo vë në pah se mungonte sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm.
- Rreziku** Mungesa e planit të menaxhimit të kontratës rrezikon mbarëvajtjen dhe implementimin e mirë të kontratave.
- Rekomandimi 9** ZKA në bashkëpunim me Kryeshefat Ekzekutiv, duhet të ndikojnë në shtimin e përgjegjësisë të menaxherët e kontratave, në mënyrë që secili prej tyre të hartojë planin për menaxhimin e kontratës për të cilën është përgjegjës.

### Çështja 10 - Dobësi jo-sistematike në prokurim- Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas LPP-së, AK nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar.
- Sipas planit të prokurimit, AUV kishte planifikuar prokurimin "Furnizim me kite dhe reagjent, materiale kimike dhe materiale harxhues për laborator", në vlerë prej 200,000€. Mirëpo në vend të zhvillimit të një prokurimi të përbashkët për tërë sasinë që do ta sillte ekonominë e shkallës, AUV kishte bërë tre prokurime të ndara gjatë vitit. Po ashtu, njëri nga fituesit kishte dorëzuar sigurimin e ekzekutimit me afat për vetëm një muaj, përderisa me dosjen e publikuar të tenderit ishte kërkuar siguri me një afat prej 13 muajve, gjë që ishte rregulluar pas këshillës në auditimin e ndërmjetëm; dhe
  - Në ZKM ishin zhvilluar gjashtë procedura të prokurimit, të ndara në periudha të ndryshme, për furnizim me mallrat e teknologjisë informative me vlerë totale 74,913€, kjo kishte rezultuar nga se njësitë kërkuese kishin bërë kërkesa për furnizim të cilat nuk ishin planifikuar në fillim të vitit.
- Rreziku** Ndarja e procedurave të prokurimit për furnizim të natyrës së njëjtë, rritë rrezikun që AK nuk do të arrijë të marrë vlerën për parane e shpenzuar. Pranimi i sigurisë së ekzekutimit në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit rrezikon që në rast të mos përmbushjes së kërkesave nga ana OE, AK të ketë humbje financiare.

**Rekomandimi 10** ZKA dhe Kryeshefi i AUV, duhet të sigurojnë përmes menaxherëve të prokurimit, se nuk do të bëhet ndarja e prokurimeve të natyrës së njëjtë. Kjo të arrihet duke planifikuar me kohë dhe duke zhvilluar procedurat sipas planifikimit, si dhe të sigurojë që kontratat nënshkruhen vetëm pas kompletimit të dokumentacionit të kërkuar.

## 4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrim

Shpenzimet tjera janë ato shpenzime realizimi i të cilave për shkak të natyrës së tyre nuk kërkon aplikimin e procedurave të prokurimit. Nga ky grup i shpenzimeve ne testuam shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, avanset dhe shpenzimet komunale. Edhe përkundër disa përmirësimeve avanset ende mbeteshin fushë për përmirësim në ZKM. Ne testuam 19 mostra në vlerë totale 64,441€.

---

### Çështja 11 - Mos-mbyllja e avanseve me kohë dhe kompensimi i punonjësve nga mallrat dhe shërbimet - Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Sipas UA 2004/07 për udhëtime zyrtare dhe Rregullës nr. 01/2013, avanset duhet të mbyllën dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në llogari brenda dy javëve pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Nga testimi i 11 avanseve të mbyllura, shtatë prej tyre, me vlerë prej 43,900€, nuk ishin mbyllur brenda afatit ligjor, me ç' rast kishte pasur vonesa në mbyllje deri në 10 muaj.

Sipas ligjit 04-L/233 për buxhetin e vitit 2014, nuk lejohet kompenzimi i punonjësve nga buxheti për mallra dhe shërbime. ASK kishte kompenzuar 63 punonjës nga buxheti për mallra dhe shërbime në vlerë 35,387€. Kompenzimi ishte për angazhime shtesë brenda orarit të punës lidhur me përpilimin e statistikave të veçanta sipas kërkesave të donatorëve.

**Rreziku** Kontrollat jo efektive në mbylljen e avanseve rrisin rrezikun e moskthimit të mjeteve dhe shfrytëzimin e tyre për qëllime tjera. Gjithashtu, kompensimet nga kategoria jo përkatëse ndikojnë në mbivlerësimin e mallrave dhe shërbimeve.

**Rekomandimi 11** ZKA duhet të sigurojë që respektohen afatet e përcaktuara ligjore për mbylljen e avanseve, gjithashtu të ndikojë në ngritjen e përgjegjësisë tek zyrtarët të cilët i krijojnë këto shpenzime, si dhe të gjitha pagesat për nëpunësit të bëhen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

### 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Ne rishikuam transaksionet sipas listës së pagave ku vërejtëm se sektori i financave është njoftuar rregullisht dhe me kohë lidhur me ndryshimet në paga dhe mëditje.

Gjatë vitit, ZKM dhe agjencitë e saj kishin kryer edhe rekrutime të stafit. Ne kemi përzgjedhur dhe analizuar 10 procedura të rekrutimit.

Po ashtu testuam edhe mostra duke përfshirë dosjet e të punësuarve të cilat ishin mbajtur dhe azhurnuar rregullisht nga zyra e personelit, varësisht prej ndryshimeve të ndodhura të stafit të punësuar.

Megjithatë, mangësitë e identifikuara duhet të tërheqin vëmendjen e menaxhmentit.

---

#### Çështja 12 - Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre dhe avancimet pa konkurs - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Ligji i Shërbimit Civil nr.03-L-149, përcakton se një pozitë nuk mund të mbahet nga ushtruesi i detyrës për më shumë se tre muaj. Në tre raste pozitat menaxhuese mbaheshin nga ushtruesit e detyrës më gjatë se afati i përcaktuar, njëri rast ishte në ZKM ndërsa dy në AUV.

Rregullorja për avancimin e nëpunësve civil përcakton se për çdo avancim duhet të shpallet konkursi i brendshëm ose i jashtëm. Në tre pozita, AUV-i kishte avancuar zyrtarët pa shpallur konkurs.

**Rreziku** Mungesa e kontratave të rregullta të punës është demotivuese për stafin që ushtron atë detyrë dhe nuk siguron angazhim adekuat për arritjen e objektivave të organizatës duke rënë në ndesh edhe me ligjin. Përderisa avancimi i zyrtarëve pa konkurs mbron mundësinë e konkurrencës duke mos siguruar që gjithmonë personi më i përshtatshëm është vendosur në pozitën përkatëse.

**Rekomandimi 12** ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it, duhet të sigurojnë zgjidhje të qëndrueshme për pozitat e mbajtura me ushtrues detyre dhe për pozita të caktuara të sigurohen mundësi të barabarta përmes konkurseve përkatëse.

#### 4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

##### **Përshkrimi**

ZKM gjatë vitit 2014 kishte dhënë subvencione për qëllime të ndryshme siç ishin ato për kthim të minoriteteve, për projekte në bashkëpunim me Komunitat, manifestime të ndryshme, për përkrahjen e OJQ dhe mediave të komuniteteve, aktivitete për të pagjeturit etj.

Në këtë periudhë ishin dhënë subvencione në vlerë 1,512,375€, pjesëmarrje më të madhe kishte Zyra për Komunitete në vlerë 1,257,932€, dhe Zyra e Kryeministrit përfshirë edhe Kabinetin me 174,593€.

Për vitin 2014 testuam 62 pagesa në vlerë 643,761€. Rreziku domethënës i identifikuar në këtë kategori është përshkruar në nenkapitullin 2.2.

---

##### **Çështja 13 -Mungesa e rregullore dhe mos raportimi i shpenzimeve nga përfituesit- Prioritet i lartë**

**E gjetura** ZKM nuk kishte rregullore apo strategji të shkruar ku do të përcaktoheshin objektivat e saj që do të arrihen me subvencionet e dhëna. Subvencionet ishin paguar bazuar në vendimet e Kryeministrit dhe marrëveshjeve në mes të Zyrës së Komuniteteve dhe përfituesve të subvencioneve, por që mungonin kriteret e qarta përmes të cilave do të përzgjidhej fituesi.

**Rreziku** Mungesa e rregullore (strategjisë) për subvencione, respektivisht caktimi i kriterëve të qarta për dhënien dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit, rritë rrezikun që mjetet e dhëna të mos arrijnë qëllimin e duhur.

**Rekomandimi 13** ZKA të sigurojë hartimin dhe aprovimin e një rregulloreje, e cila do të përcaktonte objektivat dhe kriteret, si dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit për tu siguruar se subvencioni ka arritur qëllimin për të cilin është dhënë.



## 4.5 Pasuritë dhe detyrimet

Testuam proceset e funksionimit sa i përket regjistrimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së pasurive. Një fokus i veçantë ka qenë çështja e regjistrimit në sistemet përkatëse të pasurive siç kërkohet në rregulloret relevante, si dhe menaxhimi i veturave zyrtare.

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

ZKM në fund të vitit, kishte pasuri kapitale me vlerë neto prej 2,799,191€, apo 437,807€ më pak se në vitin e kaluar, ku rënia e vlerës ishte si rezultat i zhvlerësimit të pasurive dhe mungesa e blerjeve të cilat do t'i plotësonin kushtet të kapitalizohen.

Ne vlerësuam funksionimin e kontroleve në menaxhimin e pasurive në ZKM duke përfshirë edhe ASK-ën, AUV-in dhe AShAK-un.

---

#### Çështja 14 - Mangësitë në raportimin e pasurive -Prioritet i lartë

- E gjetura** Pas analizimit të regjistrave të e-pasurisë kemi konstatuar se:
- Disa pasuri të cilat janë në posedim të ZKM-së dhe agjencive të saj nuk ishin të raportuara në fund të vitit. Toka ku ishin të ndërtuara objektet e AUV-it si dhe toka dhe ndërtesa e ASK-së, ende nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe raportuar në pasqyra financiare;
  - Regjistri kontabël nuk ishte i plotë, pasi që automjeti i cili shërben për bartjen e mostrave në AUV- në vlerë 14,840€ dhe skaneri i blerë nga ZKM-ja në vlerë 4,840€, nuk ishin regjistruar; dhe
  - Në ZKM sistemi e-pasuria nuk kishte llogaritur zhvlerësimin e disa pasurive, përderisa disa pasuri ishin regjistruar pa llogaritur TVSh, duke i nënvlerësuar pasuritë për 1,348€.

**Rreziku** Mangësitë në regjistrimin e pasurive në sistemin e SIMFK dhe e-pasurisë rezultojnë në prezantimin jo të saktë të tyre, me ç'rast mungesa e informatave të sakta dhe të plota, zvogëlon aftësinë për menaxhimin efikas të pasurive dhe vendimeve lidhur me to.

**Rekomandimi 14** ZKA dhe Kryeshefat ekzekutiv të agjencive, duhet të sigurojnë dokumentacionin përkatës për vlerësimin dhe regjistrimin e tokës dhe ndërtesave. Po ashtu, të forcohet kontrolli në mënyrë që regjistrimi dhe menaxhimi të kryhet konform rregulloreve dhe të paraqiten vlerat e plota në PVF.

### Çështja 15- Mangësitë në menaxhimin e stoqeve dhe pasurive në depo –Prioritet i lartë

- E gjetura** Në AUV në mungesë të depoistit, pranimi i furnizimeve bëhet nga zyrtari jo kompetent i cili këto evidenca nuk i regjistron në sistemin e-pasuria por në Excel.
- Në ASK raporti i komisionit si dhe vlera e stoqeve në e-pasuri nuk përputhet për 11,320€. Kjo gjendje ishte si rezultat i shpërndarjes së pasurive pa kaluar përmes depos së agjencisë.
- Rreziku** Mungesa e evidencave të stoqeve dhe mos pranimi i tyre përmes depoistit vështirëson planifikimin, mbikëqyrjen dhe raportimin adekuat dhe të saktë për pasuritë e organizatës.
- Rekomandimi 15** Kryeshefat e agjencive duhet të sigurojnë se të gjitha hyrje-daljet e furnizimeve evidentohen në sistemin e e-pasurisë, në mënyrë që edhe shënimet të jenë të sakta dhe të barabarta me raportet e komisioneve për gjendjen e stoqeve. Gjithashtu në AUV duhet të plotësohet pozita e depoistit.

### Çështja 16 - Mungesa e evidencave të plota për përdorimin e automjeteve-Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në dosjet e gjashtë automjeteve, kërkesa për udhëtime zyrtare nuk ishte plotësuar siç kërkohet me UA 03/2008 për përdorimin e automjeteve.
- Rreziku** Mosplotësimi i formularëve sipas UA për shfrytëzimin e automjeteve, rrezikon përdorimin e tyre përtej qëllimeve zyrtare, duke i shkaktuar edhe shpenzime shtesë.
- Rekomandimi 16** ZKA dhe Kryeshefat e agjencive duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrolle dhe mekanizma adekuat që mundësojnë mbajtjen e rregullt të evidencave për shfrytëzimin e veturave zyrtare.

## 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

### Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshme pasqyrojnë vlerat të cilat klientët e ZKM-së dhe agjencive obligohen për shkak të shërbimeve të ofruara dhe që ende nuk janë paguar. Në fund të vitit, vlera e llogarive të të arkëtueshme të shpalosur në PVF ishin 20,572€, kjo ishte rezultat nga shitja e gazetës zyrtare dhe për dhënen e hapsirës së AShAK-ut me qira.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

### 4.5.3 Trajtimi i borxheve

#### Përshkrim

Në PVF-të e 2014, vlera e obligimeve të papaguara të ZKM-së përfshirë dhe agjencitë ishin 192,791€, prej tyre 117,519€ ishin për mallra dhe shërbime si dhe komunal, ndërsa 75,272€ ishin për investime kapitale.

Përveç raportimit në PVF sa i përket obligimeve, Rregulla nr.02/2013 i obligon organizatat buxhetore që çdo muaj të raportojnë në MF/Thesar shumën e obligimeve të papaguara që posedojnë.

---

#### Çështja 17 - Menaxhimi jo i duhur i obligimeve -Prioritet i mesëm

##### E gjetura

Pas analizimit të raporteve të obligimeve konstatuam se:

- Në mungesë të sistemit të mirëfilltë të kontrolleve të mbrendshme ZKM-ja kishte hyrë në obligime pa zotim të mjeteve, edhe përkundër asaj se kishte mjete të mjaftueshme në këto kategori.
- Raportet mujore për obligimet e papaguara të ZKM-së nuk i përfshinin të gjitha faturat e papaguara<sup>11</sup>.
- Në 10 raste me vlerë totale prej 113,901€, faturat ishin paguar pas afatit ligjor prej 30 ditëve nga pranimi i tyre.

##### Rreziku

Rritja e obligimeve të papaguara, reflekton një menaxhim jo efikas të buxhetit, duke ndikuar edhe në mbarëvajtjen e shpenzimit buxhetor të vitit vijues. Përderisa mos raportimi i plotë i obligimeve i pamundëson MF-it dhe palëve tjera të interesit të kenë informacionin e duhur rreth obligimeve financiare të ZKM-së.

**Rekomandimi 17** ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të forcojnë sistemin e kontrollit për tu siguruar se të gjitha obligimet evidentohen dhe raportohen mbrenda afateve të përcaktuara ligjore.

---

<sup>11</sup> Në raportin e muajit shkurt mungonin obligimet në vlerë 7,640€ të AKMRSB si dhe 3,260€ të AUV-it, në raportin e muajit korrik mungonin obligimet e AUV-it në vlerë 6,234€, ndërsa në muajin tetor mungonin 4,220€ të ASK-së.

---

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

NJAB kishte përgatitur planin vjetor në harmoni me planin strategjik. Për vitin 2014 kishte planifikuar katër auditime, prej tyre kishte arritur ti përfundonte tri raporte. Komiteti i Auditimit kishte mbajtur dy takime ku ishin trajtuar raportet e AB-se dhe ZAP-it.

NjAB, përmes raporteve të auditimit, i kishte ofruar menaxhmentit informata dhe vlerësime rreth funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

---

### Çështja 18 – Mosrealizimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm-Prioritet i mesëm

**E gjetura** Për shkak të strukturës komplekse të ZKM-së, përbërja e NjAB-së me vetëm një auditor (drejtor të auditimit), vështirëson arritjen e mbulueshmërisë me auditim në të gjitha agjencitë e ZKM-së.

**Rreziku** Në mungesë të stafit të NjAB-it, rrezikohet që mos të auditohen fusha kyçe në agjencitë ekzekutive, e si rezultat i kësaj menaxhmenti të mos jetë i informuar rreth proceseve për të cilat mund të merren vendime jo të duhura.

**Rekomandimi 18** ZKA duhet të konsiderojë plotësimin e NjAB-it me staf të mjaftueshëm, i cili do të ndikonte në shtimin e sigurisë lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshme në ZKM.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	1. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së duhet të sigurojë që pagesat e subvencioneve janë bërë vetëm në kuadër të kornizës ligjore ku raporte të hollësishme janë siguruar në afate kohore të caktuara. Këto duhet të konfirmojnë arritjen e objektivave dhe vlefshmërinë e shpenzimeve dhe të mbështetur nga një nivel përshtatshëm dëshmive në veçanti të subvencioneve të dhëna përmes vendimeve të Kryeministrit. Ndarja e subvencionit në këste dhe kushtëzimi i çdo kësti me raportim mbi shpenzimin e fondeve të kështit paraprak mund të jetë alternativa më e duhur e cila do të stimulojë një përgjegjësi të madhe të përfituesve.			Nuk janë marrë masa, ende nuk kishte ndonjë rregullore të aprovuar.
Rekomandimet e vitit paraprak	2. Plani i rishikuar i veprimit përcakton një afat kohor praktik por sfidues për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP me identifikimin e anëtarëve të përgjegjshëm dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Zbatimi i planit duhet të rishikohet nga ZKM në baza tremujore.		Rekomandimet ishin diskutuar në takimet me Drejtorët dhe në disa takime me Kryeshefat. Ende nuk kishte raporte të qarta të cilat do të tregonin nivelin e implementimit në periudha.	



Qeverisja e mirë	3.ZKM duhet të sigurojë që marrëveshjet e zgjeruara të llogaridhënies janë vendosur në mes të ZKM-së dhe agjencive të saj të cilat sigurojnë struktura efikase të raportimit për të mbështetur menaxhimin financiar në kohë dhe të fuqishëm nga ZKM mbi të gjitha fushat e përgjegjësisë dhe të mbështesë një proces efektiv të konsolidimit PVF.			Nuk janë marrë masa,pasi që Kryeshefat ende nuk dërgonin raporte të rregullta me shkrim tek ZKA për çështjet administrativo-financiare.
	4.Sekretari i Përgjithshëm duhet të kryejë një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Kjo duhet të përfshijë raporte që i ofrojnë një nivel të përshtatshëm të të dhënave financiare dhe operationale që mbulon të gjitha përgjegjësitë ZKM. Takime të ekipit të menaxhimit duhet të regjistrohen për të demonstruar shqyrtim kritik.		Drejtorët e departamenteve kishin dorëzuar raporte javore të rregullta tek ZKA rreth proceseve në vazhdim, por cilësia dhe niveli i informatave kanë ende hapësirë për përmirsim.	
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	5.Përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimin në vitet e mëparshme / dhe ndryshimet e pritura të vitit. Performanca buxhetore duhet të monitorohet në baza mujore dhe pengesat për nivelet e planifikuara të ekzekutimit të buxhetit të identifikohen dhe adresohen me kohë.		Rekomandimi ishte adresuar pjesërisht ,pasi që krahasuara me vitin e kaluar kishte ngritje tek ekzekutimi i buxhetitqë ishte në nivel prej 84%, por prap nuk ishte implementim i kënaqshëm.	

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	6.Të shtohet komunikimi me MF për të siguruar që hartimi i buxhetit dhe klasifikimi i shpenzimeve të bëhet sipas planit kontabël të thesarit për të mundësuar regjistrimin dhe raportimin e duhur të shpenzimeve			Nuk ishte adresuar pasi që edhe paguheshin nga investimet kapitale furnizimet që i takonin mallrave dhe shërbimeve në AUV.
Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)	7.Kryeshefi në AUV duhet të sigurojë një zgjidhje të përshtatshme për softuer i cili zhvillohet dhe testohet brenda vitit aktual financiar me theks të vendosur në nivelin e duhur të funksionalitetit, në mënyrë që të plotësoj kërkesat e specifikuar të menaxhimit.		AUV kishte shpallur tenderin në pjesën e fundit të vitit ,ku edhe kishte pranuar ofertat për fazën parakualifikuese. Ende nuk ishte implementim të plotë për shkak se tanimë lënda ishte në OSHP.	
	8.Kryeshefi Ekzekutiv në AUV duhet të analizoj “tregun aktual të kafshëve” në Kosovë për të përcaktuar arsyet potenciale për mungesë të ofertuesve për shitje të mishit dhe të përdor këtë informacion për të kërkuar më shumë interes në ankand. Rregullat formale apo një udhëzim administrativ duhet të hartohet për të siguruar procedura në kohë dhe efikase për shitjen me ankand të mishit të konfiskuar.		AUV kishte aprovuar “Rregulloren për shitjen dhe asgjësimin e kafshëve të konfiskuara”, por ende vazhdonte fenomenin e aplikimit nga vetëm një ofertues nëpër ankande.	

Shpenzimet-Prokurimi	9.Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të përcaktojnë se pse kërkesat specifike të procedimit të pagesave nuk janë adresuar në mënyrë të vazhdueshme dhe për të identifikuar në mënyrë të qartë barrierat për zbatimin efektiv të kontrolleve ekzistuese. Kontrollat e shtuara / rritur për shqyrtim mbikëqyrës duhet të zbatohen për të siguruar që gabime të ngjashme janë shmangur në të ardhmen.			Nuk ishte adresuar, edhe këtë vit kishte mjaft mangësi në procesimin e pagesave.
	10.Kryeshefi në AUV duhet të rishikojë procedurat e prokurimit në rastet e identifikuara më lart për të përcaktuar se pse kërkesat specifike të prokurimit nuk janë adresuar dhe zbatuar kontrolle të zgjeruara për të siguruar që gabime të ngjashme janë shmangur në të ardhmen			Nuk ishte adresuar. Edhe këtë vit në AUV kishte mangësi në dokumentet e kërkuara për tenderuesin e suksesshëm.
Shpenzimet jo përmes prokurimit	11.Sekretari i Përgjithshëm duhet të rishqyrtojë nevojën për aplikimin e rregullave ekzistuese lidhur me avanset dhe të sigurojë se arritja e afateve kohore të kërkuara monitorohet në mënyrë formale dhe raportohet tek menaxhmenti i lartë në periudhë tre mujore			Nuk ishte implementuar pasi që edhe këtë vit kishte shumë vonesa në mbylljen e avanceve.
Subvencionet dhe Transferet	12. Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë hartimin e një politike në të cilën do të përcaktoheshin prioritetet për subvencione, si dhe do të definonte objektivat, kriteret dhe kërkesat për raportim.			Nuk ishte implementuar. Ende nuk kishte politikë të shkruar për subvencione.

Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	13. Kryeshefat Ekzekutiv të agjensioneve vartëse duhet të sigurojnë që janë forcuar mekanizmat e kontrollit të cilat sigurojnë se regjistrat e pasurisë janë të azhurnuar me informata të sakta dhe të plota në secilin agjension para konsolidimit në PVF, dhe se janë bërë kontrole adekuate lidhur me shifrat e raportuara.	AShAK kishte rekrutuar zyrtar të depos si dhe ëshë deleguar puna e menaxhimit të pasurisë. Veturat nga donacionet ishin regjistruar në AUV.		
	14. Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë që janë ndërmarr masat konkrete për sigurimin e dokumentacionit përkatës për posedim të tokës dhe ndërtesës , krijimin e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e pasurisë, regjistrimin e tyre si dhe raportimin në PVF.			Nuk janë marrë masa. Ende nuk ishin vlerësuar dhe paraqitur në pasqyra pasuritë si Toka dhe ndërtesa e ASK-së si dhe Toka e AUV-it.
	15. Kryeshefi në AUV të siguroj që aplikacioni <i>e-pasuria</i> është funksionalizuar dhe se mbahen evidenca të plota dhe të sakta për pranimin, shpërndarjen dhe gjendjen e stoqeve.		Ishte adresuar pjesërisht pasi që kishte përmirsime tek <i>-epasuria</i> , por mungonte depoisti dhe regjistrimi i stoqeve në <i>e-pasuri</i> .	
Menaxhimi i automjeteve zyrtare	16. Sekretari i Përgjithshëm të forcojë kontrollin sa i përket përdorimit të automjeteve në mënyrë që të sigurojë se automjetet përdoren vetëm për qëllime zyrtare në përputhje me UA 03/2008.		Formularët ishin plotësuar , por ne disa prej tyre kishte mos përputhje me UA.	

Trajtimi i të arkëtueshmeve	17. Kryeshefi në AUV duhet të siguroj që janë të evidentuara të gjitha llogaritë e arkëtueshme dhe janë të pasqyruara në shënimet shpjeguese të PVF të cilat i dërgohen ZKM-së për konsolidim.	Ishte adresuar		
Trajtimi i borxheve	18. Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat Ekzekutiv të marrin masat e duhura për të siguruar se kryejnë me kohë të gjitha obligimet, dhe nuk hyn në obligime pa zotimin e mjeteve.			Nuk ishte adresuar. Ende kishte obligime të papaguara , si dhe pagesat procesoheshin me vonesë.
Sistemi i auditimit të brendshëm	19. Kryeministri duhet të sigurojë staf të mjaftueshëm për të siguruar NjAB efektiv dhe të siguroj se aktivitetet në të ardhmen bazohen në rrezik duke ofruar mbulueshmëri të të gjitha fushave të rëndësishme çdo vit.			Nuk ishte adresuar.